



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr.134, datë 13.03.2024

**PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË
GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË
SHPALLUR ME VENDIMIN NR.23 DATË 18.01.2023, PËR KANDIDATEN ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 13.03.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e znj. {...} nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.23 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidates për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës,

VËREN

I. TË DHËNA MBI KANDIDIMET

1. Me Vendimin nr.11- nr.24, datë 18.01.2013 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 21 deri nr.24 datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2. Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 18.01.2023, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 01.02.2023.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira nr.11 deri nr. 24 datë 18.01.2023 kandidoi edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja) gjyqtare në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, aktualisht e transferuar me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

II.TË DHËNA MBI PROCEDURAT

4. Në të njëjtën periudhë kohe, Këshilli hapi edhe disa procedura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, pozicione të cilat ka kandiduar dhe znj. {...}.

5. Referuar sa më lartë, kandidatja znj. {...}, në zbatim të pikës 5 të nenit 43 dhe pikës 6 të nenit 48 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), : “Kandidati nuk mund të kandidojë në më shumë se tre pozicione të lira që janë në proces, qofshin këto procedura ngritje në detyrë apo procedura lëvizje paralele, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës”, në komunikimin elektronik të datës 03.02.2023 është njoftuar nga Këshilli të rikonsiderojë aplikimet e saj.

6. Në përgjigje të komunikim elektronik të datës 03.02.2023 protokolluar me aktin nr. 991 prot., datë 03.02.2023 nga ana e Këshillit, kandidatja ka konfirmuar marrjen e komunikimit duke përcaktuar pozicionin e lirë, konkretisht edhe për nr. 23 datë 18.01.2023.

7. Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimeve mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etike dhe profesionale (shtojca nr. II) për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

8. Me Vendimin nr. 295, datë 30.05.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1(një) vlerësim”, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1(një) vlerësim..

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ... 2. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;... ”.

9. Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidaten znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të kandidimit të saj për lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë të përmendur më lart, Këshilli, me Vendimin nr. 351, datë 06.07.2023, ka vendosur:

1. *Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

III. TË DHËNA MBI KËRKESËN PËR TËRHEQJEN NGA KANDIDIMI

10. Më datë 29.02.2024 me anë të komunikimit elektronik kandidatja znj. {...}, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 23 datë 18.01.2023, në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, protokolluar në Këshill me aktin nr. 1327 prot., datë 29.02.2024 duke parashtruar se: *“bashkëlidhur do të gjeni kërkesën time për heqje dore nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për arsye objektive”*.

11. Në rrethanat sa sipër, përgatitet ky vendim bazuar në pikën 29, Seksioni Ç, Kreun IV, të Vendimit të Këshillit nr.320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, ku përcaktohet se: *“Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi në çdo kohë, derisa nuk ka përfunduar procedura e lëvizjes paralele, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim.”*. si dhe në pikën 59, Seksioni C, Kreun V, të Vendimit nr.320/2020 ku përcaktohet se: *“Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.”*

12. Në Mbledhjen e datës 01.03.2024 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit paraprak të ndjekur për kandidaten znj. {...} si dhe po ashtu, nëse vlerëson të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja për t’u tërhequr nga kandidimi për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.23 datë 18.01.2023, i propozoj që, bazuar në pikën 63, Seksioni Ç, Kreu V, të Vendimit nr. 320/2020, të vendosë dërgimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

IV. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË KANDIDATIT

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e lëvizjes paralele të gjyqtarëve, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit për Statusin.

14. Këshilli, në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme, duke u mbështetur në Ligjin për Statusin, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, referuar për këtë në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (më poshtë si Ligji për Qeverisjen). Sipas nenit 43 të Ligjit për Statusin i ndryshuar, procedura administrative për lëvizjen paralele të

gjyqtarëve fillon me kërkesën e tyre për shprehje të interesi. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, çka çon në përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat. E drejta e kandidatit për t'u tërhequr nga kandidimi buron nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 64, pika 2, sipas të cilit: *“Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka”*. Nga ana tjetër, përfundimi i procedurës administrative për shkak të tërheqjes së kërkesës së palës përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, por edhe në nenin 94, pika 1, të këtij Kodi, ku përcaktohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

15. Rregullimet ligjore si më lart janë reflektuar edhe në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Vendimin 320/2020. Kështu, në Kreun IV, Seksioni Ç, pika 29, të tij, përcaktohet se: *“Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi në çdo kohë, derisa nuk ka përfunduar procedura e lëvizjes paralele, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim”*.

16. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara, konstatohet se kandidatja znj. {...} brenda afatit të kandidimit ka paraqitur kërkesën për tërheqje nga procedura e lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 23 datë 18.01.2023. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së verifikimit të kushteve të tjera ligjore për lëvizjen paralele për këtë pozicion të lirë, ndërsa Këshilli ende nuk kishte marrë një vendim final, kandidatja u tërhoq nga kandidimi në këtë procedurë lëvizjeje paralele, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit një kërkesë me shkrim, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullneti i saj për t'u tërhequr nga kandidimi.

V. KONKLUZIONE

17. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidatja z. {...} të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e saj për t'u tërhequr nga kandidimi për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 23 datë 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për këtë kandidatë.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23 datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR